

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT
TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS:**

Vendodhja : Kukes, Lagjja Nr.3, Rruga
Mahmut Daci,Zona Kadastrale Nr.2315,
Nr.Pasurie 83/10.

**"PRODHIMI DHE AMBALAZHIMI I
PIJEVE ALKOLIKE DHE
JOALKOLIKE"**

Kërkues: "DOGJANI" sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:


"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator

Elidiana Shehu

Altin Ahmeti

(Cert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)



Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Tetor, 2017

1. TE PERGJITHSHME, PERSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

1.1. Hyrje

Legjislacioni kombetar, direktivat europiane te fushes se mjedisit dhe konventat nderkombetare, ne te cilat vendi yne eshte pale, parashetrojne kerkesa qe synojne mbrojtjen e shendetit human dhe mbrojtjen e mjedisit si nje te tere.

Trajtimi i integruar, kerkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore ne njeh menyre te perforcuar reciprokisht. Megjithate, duhet gjetur njeh ekuiliber midis nivelit te shfrytezimit te mjedisit dhe mbrojtjes se tij. Vonesat ne pershtatjen e ketij trajtimi te integruar dhe vazhdimesia me veprimtari, te cilat e demtojne se tepermi mjedisin, rrezikojne shendetin publik dhe pakesoje cilësinë e jetës, do te çojne ne njeh rritje te madhe te koston se pergjithshme te zhvillimit ekonomik.

Objekti i raportit te permbledhjes joteknike te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te projektit "**Prodhimi dhe ambalazhimi i pijeve alkolikedhe jo alkolike**", me vendodhje ne Kukes, Lagjja Nr.3, Rruga Mahmut Daci, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 83/10. eshte:

- percaktimi, pershkrimi dhe vleresimi i ndikimeve te pritshme mjedisore te zbatimit te projektit.
- propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.


1.2. Informacion i shkurter mbi shoqerine

Subjekti investitor i ketij aktiviteti eshte "DOGJANI" Sh..p.k me NIPT" L78231202Q. Ky subjekt eshte themeluar ne date 30/08/2017 dhe aktualisht ka si perfaqesues ligjor Z. Fatos Dogjani. Objekti i veprimtarise se ketij subjekti sipas percaktimit ne Ekstraktin e Qendres Kombetare te Regjistrimit eshte: *Fabrika e perpunimit te frutave dhe prodhimit te pijeve alkolike dhe joalkolike. Tregtim me shumice e pakice te pijeve alkolike dhe joalkolike. Import-eksport.*

1.3. Projekti i Propozuar

Qellimi i aktivitetit është "Prodhimi dhe Ambalazhimi i pijeve Alkolike dhe Joalkolike" me vendodhje ne Kukes, Lagjja Nr.3, Rruga Mahmut Daci,Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 83/10.

Ortofoto e aktivitetit ne vleresim



ORTOFOTO DIXHITALE

Data e Fotografimit 24/06/2007

Nr. Vetdeklarimit: 6/11



Qytet/Fshati KUKËS
 Zona Kadastrale: 2315
 Nr i Pasurisë: 63/10
 Indeksi Hartes: E19-24-03c, KU-K-7
 Shkalla: 1 : 500

Njesia Vendore QARKU
 Emri: FATOS
 Atesia XHEMALI
 Mbiemri DOGJANI

x= 452574.12
y= 4657570.52

Sistemi Koordinativ: Projektioni UTM34 me Elipsoid WGS84

x= 452669.04
y= 4657570.52




x= 452574.12
y= 4657483.64

x= 452669.04
y= 4657483.64

Per Drejtorine Rajonale te ALUIZNI-t

BUJAR ZEJNELAJ
 PERGJEGJESI I SEKTORIT TE GIS-it



GENPLAN

BASHKIA/KOMUNA: KUKËS		NR I DOSJES SË VET DEKLARIMIT: 6/11 ZONA KADASTRALE: 2315 NR. PASURISË: 83/10 INDEKSI I HARTËS: E19-24-03c, KU-K-7 SHKALLA: 1:500 ADRESA E PASURISË: Qarku: KUKËS Bashkia/Komuna KUKËS RR/L3	
DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t: KUKËS		P/G Shk. Kati Ap. SIPËRFAQJA E PARCFLËS NDËRTIMORE = 500 SIPERFAQJA E NDËRTIMIT = 96.25	
PERGJEGJESI I SEKTORIT TE HARTOGRAFISE: BUJAR ZEJNELAJ emër mbiemër nënshkrimi		POSEDUESI: FATOS XHEMALI DOGJANI emër atesia mbiemër	
DATA: 27/08/2010			

x= 452576.98 UTM 34N / WG S84 x= 452666.98
 y= 4657560 y= 4657560

x= 452576.98 x= 452666.98
 y= 4657494.16 y= 4657494.16

KUFITARËT: VERI Pemtore Nr.Pas 83/6 JUG Pemtore Nr.Pas 83/6 LINDJE Pemtore Nr.Pas 83/6 PERENDIM Pemtore Nr. Pas 83/6			Legjenda + Hyrja ne Objekt [Blue Box] Objekt [Black Box] Parcele [Dashed Box] Kufi parcele	
MIRATOI DREJTORI DREJTORISE RAJONALE TE ALUIZNI-t KUKËS RUSHIT GASHI emër mbiemër nënshkrimi			vula	

1.4. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e mjedisit ku do te përfshihen kushtet fizike, të burimeve ujore, biologjike, atmosferike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese të përfituara rishitas mbi kushtet e mjedisit te sheshit qe do te shfrytezohet, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

1.5. Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuara në procesin e VNM përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, cilesine e ajrit, tokes, mjedisit biologjik dhe situatën social-ekonomike dhe kulturore. Burimet e vlerësuar social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të shfrytëzimit të burimit, rehabilitimit dhe monitorimit.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të kërkuar.

Metodologjia e hartimit të këtij raporti të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Vendimit të KM Nr. 13, datë 04.01.2013 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Metoda e përgatitjes së VNM

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e raportit të VNM-së u bazua në:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhëzimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese në Shqipëri për të zgjidhur dhe lehtësuar impaktet shoqërore dhe mjedisore të studimit;
- Vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve bazë të rregullave shqiptare duke identifikuar boshllëqet dhe duke paraqitur rekomandime për t'i zgjidhur ato;
- Përgatitjen e udhëzimeve për identifikimin dhe vlerësimin e natyrës dhe magnitudës së impakteve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë përgatitjen e kriterëve seleksionues socialë dhe mjedisorë për të përzgjedhur projektet për implementimin dhe për të përcaktuar nivelin e studimeve/vlerësimeve sociale dhe mjedisore që kërkohen;
- Sugjerimet mbi modalitetet për përgatitjen e masave lehtësuese të nenprojektit në lidhje me zonën ku po ekzekutohet ky i fundit.

Institucionet pergjegjese kane ne organiken e tyre nje sere inspektorësh dhe teknike si ne nivelin qendror ashtu dhe ne ate rajonal, si dhe nje specialist te mjedisit, qe do te jete pergjegjes per monitorimin e ketij studimi dhe te vleresimeve te tjera mjedisore specifike si dhe do te trajtojne njesite e qeverisjes vendore per t'iu permbajtur kerkesave te parashtruara ne Leje Mjedisore

2. MBI LEGJISLACIONIN MJEDISOR DHE PERPUTHJET E TIJ ME ATE NDERKOMBETAR

2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezëve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, paisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

2.2. Kuadri ligjor kombetar

Sa me sipër, ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si me poshtë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet në mënyrë të drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis. Keto ligje së fundmi janë përafëruar plotësisht me ligjet e Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit dhe Vleresimin e Ndikimit në Mjedis.

Bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 Për lejet e mjedisit, në Aneksin Nr.1 ,ky projekt klasifikohet në listën e aktiviteteve që duhet të përshten me leje mjedisore të tipit B për të gjitha instalimet.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM para implementimit. Kategoritë e VNM-ve janë:

VNM paraprake. Ky vlen për projekte që mund të kenë impakte potenciale me të vegjël në permasa që sërisht kërkojnë një vleresim profesional të impakteve të tyre. Keto përfshijnë projekte që janë listuar në Shojcën 2 të Ligjit për VNM dhe ndryshime apo rehabilitime të projekteve të listuar në Shtojcën 1 dhe që nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen për projekte me impakte potencialisht të konsiderueshme, siç figurojnë në listën e Shojcës 1 të Ligjit, ato projekte të listuara në Shtojcën 2 për të cilët Agjencia Kombëtare e Mjedisit mendon se do të kenë një impakt të konsiderueshëm mbi mjedisin (bazuar në informacionin e siguruar nga propozuesi në kohën e aplikimit) dhe veprimtaritë që janë për të implementuar në zonat e mbrojtura apo zona bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" i ndryshuar**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"**
- **Ligj nr. 37/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, "për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë", të ndryshuar**
- **Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"**
- **Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura". I ndryshuar me:-Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin".**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"**
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"**
- **Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfilllet e mbetjeve"**
- **Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"**
- **Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 "Per Miratimin e rregullave pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se VNM-se..."**
- **Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.**
- **Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror"**

Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:

- **Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: "Për ratifikimin e konventes se Aarhusit"** Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tiu drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.

- **Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos" në konventën për ndryshimet klimatike (UNFCCC).**
- **Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: "Për ratifikimin e protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor".**
- **Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit për protokollin e Montrealit" Për substancat që hollojnë shtresën e Ozonit.**
- **Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotesve"**

2.4. Metodologjia e Vlerësimit

Për hartimin e raportit të VNM, porositesi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik, inxhinierik dhe juridik. Ky projekt përgatitet me kërkesë të investitorit, subjekti "DOGJANI" Sh.P.K, si dhe janë kryer inspektime në terren për identifikimin e elementeve mjedisore dhe të biodiversitetit.

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit për procedurat shqiptare të VNM-se

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	Procedura që Duhet Ndjekur (Duke plotësuar Standartet Shqiptare)
Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit"	Sipas kërkesave të ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", Shtojca 1 për Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C ky aktivitet klasifikohet për paisje me leje mjedisore të tipit B.

3. PËRSHKRIMI I FUNKSIONIMIT TE AKTIVITETIT

3.1. Te pergjithshme

Objekti i projektit te propozuar eshte venia ne pune e fabrikes per "Prodhimin dhe ambalazhimin e Pijeve alkolike dhe joalkolike", e ndodhur ne Kukes, Lagjja Nr.3, Rruga Mahmut Daci,Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 83/10.

Kapaciteti i Projektuar

Subjekti "DOGJANI"sh.p.k do te prodhoje:

- a) 7000 litra vere/vit
- b) 1500 litra raki/vit
- c) 2000 litra lengje frutash

3.2. Pershkrimi i funksionimit te aktivitetit

Teknologjia e prodhimit të verës së kuqe e të bardhë

Varietetet e vendit dhe të huaja që përdoren për prodhimin e verërave

Varietetet autoktonë të rrushit për prodhimin e verës së bardhë dhe kuqe janë: Sheshi i bardhë, Debina e bardhë dhe Pulësi dhe Sheshi i zi, Kallmet, Vlosh, Serina dhe Debina e zezë.

Varietetet e huaja që kultivohen në vendin tonë janë: Merloti, Kabërne Savinjo, Riesling Dimiati, Pinoti, Barbera, Muskatet, Mavrudi, Tokai, Pamidi, etj.

Marrja e rrushit në dorëzim, dërrmimi, heqja e frenjave

Rrushi vilet kur ka arritur pjekurinë teknike dhe sillet menjëherë në repartet e përpunimit mekanik të tij. Si fillim bëhet marrja e rrushit në dorëzim duke matur densitetin e tij, aciditetin dhe përmbajtjen e sheqerit. Dërrmimi i rrushit bëhet me dërrmuese pa copëtimin e cipave dhe frenjave dhe pa thyerjen apo çarjen e farave

Përparësitë e procesit të dërrmimit:

- Realizon ndarjen e lëngut nga pjesët e ngurta
- Lehtëson transportimin me pompë
- Lehtëson formimin e kapeles së bërsive
- Realizon shpërndarjen e majave
- Lehtëson fillimin e fermentimit
- Lehtëson macerimin
- Lehtëson tretjen e lëndëve ngjyruese dhe tanike
- Shkurton zgjatjen e fermentimit
- Veçoritë e prodhimi të verë së kuqe.

Vera e kuqe përftohet nga fermentimi alkoolik i lëngut të rrushit, që shoqërohet me tretjen në të, të disa përbërësve të pjesës së fortë të veshulit të rrushit (cipat, farat, nganjëherë frenjat), pra shqërohet me procesin e macerimit. Prania e bërsive është baza karakteristike e prodhimit të verës së kuqe, e cila dallohet nga prodhimi i verës së bardhë pikërisht nga ky fakt.

Dihet se lëndët ngjyuese, tanike dhe aromatike gjenden kryesisht në cipën e kokrrës së rrushit, ndërsa në tul më pak. Kështu cipat i japin verës së kuqe jo vetëm lëndët ngjyuese, por edhe substanca të tjera me veti shijësore dhe aromatike dhe që përbëjnë vetitë organoshqisore. Në këtë mënyrë dallohet prodhimi i verës së kuqe nga e bardha.

Në prodhimin e verës së kuqe dallohen dy karakteristika kryesore:

Cilësia e rrushit të grumbulluar, që varet nga kushtet e jashtme (klime dhe toka). Grumbullimi i lëndëve ngjyuese në kohën e pjekurisë varet kryesisht nga ndriçimi diellor i mjaftueshëm dhe temperatura e lartë. Kur rrushi preket nga sëmundjet, shkatërrohen polifenolet dhe lëndët ngjyuese. Prandaj rrushi duhet të grumbullohet në varësi të pjekurisë dhe gjendjes shëndetësore.

Kryerja e fermentimit malolaktik, proces i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Për uljen e aciditetit, për zbutjen e verës dhe për përmirësimin e shijes tek verërat e kuqe me aciditet të lartë, kërkohet të kryhet fermentimi malolaktik, i cili formon acidin laktik. Për verërat me aciditet të ulët fermentimi malolaktik nuk këshillohet të kryhet, sepse ka vështirësi ruajtja e saj, si pasojë e uljes shumë të aciditetit.

Prodhimi i verës së kuqe kryhet sipas tre proceseve bazë:

- Fermentimi alkoolik
- Qëndrimi në bërsi
- Fermentimi malolaktik

Këto procese kryhen në katër etapa:

- Veprimet mekanike të përpunimit të rrushit
- Fermentimi me bërsi
- Ndarja e verës
- Përfundimi i fermentimit

Skema teknologjike e prodhimit të verës së kuqe:

- Pranimi
- Seleksionimi
- Dërmimi
- Sulfitimi
- Toçitje
- Hedhja e majasë
- Toçitje
- Fermentimi alkoolik
- Toçitje
- Vetërrjedhja
- Presimi
- Sulfitimi (sipas rastit)

- Fermentimi i dytë dhe dekantimi
- Tërheqje
- Trajnime të ndryshme (sipas rastit)
- Ambalazhim
- Vjetërim në shishe ose vjetërim në voza
- Ambalazhim

Veçoritë e prodhimit të verës së bardhë

Vera e bardhë përfitohet kryesisht nga fermentimi i lëngut të rrushit, pa macerimin e pjesëve të ngurta të cipës, farave dhe frenjave. Veçoria kryesore dalluese për prodhimin e verës së bardhë është se procesi i presimit të bërsive për të shmangur rritjen e ngjyrës kryhet para fermentimit. Prosesi i fermentimit tek vera e bardhë bëhet më ngadalë, sepse mungon prania e bërsive, pra ka një numër më të vogël majash në krahasim me verën e kuqe. Gjithashtu fermentimi i mushtit të bardhë duhet të kryhet në temperaturë më të ulët se sa në prodhimin e verës së kuqe. Si rregull duhet që proceset mekanike të bëhen sa më shpejt, në mënyrë që të kufizohet zgjatja e takimit të lëngut me pjesët e ngurta dhe me ajrin. Në verërat e bardha nuk lejohet të zhvillohet fermentimi malolaktik sepse çon në uljen e aciditetit të përgjithshëm të verës, gjë që e bën verën të shpëlarë.

Skema teknologjike e prodhimit të verës së bardhë:

- Pranimi
- Seleksionimi
- Dërmimi
- Vetërrjedhja
- Presimi
- Sulfitimi
- Toçitje
- Hedhja e majasë
- Toçitje
- Fermentimi alkoolik
- Tërheqje, sulfitimi (sipas rastit)
- Përfundimi i fermentimit dhe dekantimi
- Tërheqje
- Trajnime të ndryshme (sipas rastit)
- Ambalazhim
- Vjetërim në shishe ose vjetërim në voza
- Ambalazhim
- Mbushja dhe ambalazhimi i verës
- Enët prej qelqi, larja e tyre

Shpërndarja dhe marketingu i verës sot bëhet kryesisht në enë qelqi me nxënësi të mdryshme (shishe, balona, damixhanë, etj). Çdo tip vere kryesisht ato cilësore, kanë një shishe të caktuar. Zakonisht zgjidhen shishe prej qelqi në ngjyrë të gjelbër për verërat e bardha dhe prej qelqi të errët ose të turbullt për verërat e kuqe, të cilat mbrohen nga veprimi i dritës.

Shishet para mbushjes duhet të lahen mirë sidomos kur përdoren shishe që qarkullohen.

Mbushëset e shisheve

Mbushja e shisheve mund të realizohet me pajisje të thjeshta që mund të jenë:

manuale, automatike

Është mirë që vera të mbushet në kushte sterile që mund të arrihet në të ngrohtë dhe në të ftohtë, me ose pa shtim të anhidritit sulfuror.

Mbushëset janë dy llojesh:

- Mbushëse në nivel
- Mbushëse në sasi

Mbushësja në nivel siguron një lartësi lëngu në çdo shishe pavarësisht nga kapaciteti që ka shishja. Në qoftë se ndryshon kapaciteti ndryshon dhe përmbajtja, por jo hapësira që mbetet e pambushur, ajo mbetet gjithmonë e njëjtë.

Thithja e oksigjenit gjatë mbushjes paraqet një problem, që duhet të reduktohet në maksimum. Kjo mund të arrihet duke:

Kufizuar hapësirën e qafës së shishes

Rritur në kufijtë e lejuar sasinë e SO₂

Mbushur hapësirën boshe të qafës me gaze inerte si anhidrit karbonik dhe azot

Taposja dhe konfeksionimi

Pas mbushjes së shisheve bëhet taposja me:

Tapatriçe manuale

Tapatriçe automatike

Llojet e tapave janë:

- Tapa druri
- Tapa plastik (silikoni)
- Tapa metalik me vidë

Shishja konfeksionohet me një etiketë kryesore që quhet ndryshe etiketa e trupit, një etiketë të dytë që quhet kundraetiketë dhe një veshje letre rreth qafës së kapsulës.

Etiketa e trupit duhet të përmbajë:

- Emrin e prodhuesit
- Vitin e vjeljes
- Vëllimin e shishes
- Gradën alkoolike

Etiketimi kryhet me:

- Makina gjysëm-automatike
- Makina automatike

Shfrytëzimi i mbeturinave që dalin nga prodhimi i verës

Bërsitë e rrushit dhe shfrytëzimi i tyre

Gjatë procesit teknologjik të prodhimit të verës dalin mbeturina si:

- Bërsi
- Llumra
- Farat
- Cipat
- Lëndë tartrike, etj.

Nga shfrytëzimi i tyre përfitohen produkte si:

- Raki
- Alkool etilik
- Vaj ushqimor
- Ushqim për kafshët, etj.

Bërsitë e rrushit janë mbetje teknologjike që dalin gjatë prodhimit të verës. Ato përbëjnë rreth 13 – 17 %. Bërsitë janë dy llojesh:

Bërsi të pafermentuara ruhen duke u përzierë me një sasi bërsish të fermentuara, për të shndërruar sheqernat në alkool etilik.

Bërsi të fermentuara që dalin nga presimi i bërsive gjatë përftimit të verës së kuqe.

Bërsitë ruhen në mungesë të ajrit që të mos oksidohen dhe të mos shkatërrohen kripërat tartrike si dhe të mos mbulohen me myqe. Ato ruhen në enë druri duke i ngjeshur dhe mbulohen me një shtresë dheu deltinor në trashësi 30-35cm, e cila nuk lejon futjen e ajrit. Bërsitë përdoren për prodhimin e rakisë dhe alkoolit etilik.

Llumrat dalin gjatë tërheqjeve të ndryshme që i bëhen verës dhe së bashku me bërsitë përdoren për përftimin e rakisë.

Farat e rrushit kanë 10 – 20 % vaj, i cili nxirret me anë të presave hidraulike dhe bërsitë që mbeten mund të përdoren si ushqim për kafshët. Vaji që mbetet në bërsi pas presimit, merret me anë të disa tretësive organike dhe përdoret në industrinë e prodhimit të sapunit, bojrave të vajit etj. Pas heqjes së vajit me tretësia organike bërsitë përdoren për pleh.

Cipat përdoren për përftimin e lëndëve ngjyuese në industrinë e ëmbëlsirave, të pijeve freskuese etj.

Lëndët tartrike përdoren për përftimin e kripërave tartrike që më pas këto të fundit përdoren për prodhimin e acidit tartrik.

3.3. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij aktiviteti është Prodhimi dhe ambalazhimi i pijeve alkolike dhe joalkolike

3.4. Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes funksionale te aktivitetit do te jene kryesisht Mbetjet e ngurta (bersi), te cilat shfrytëzohen per te përftuar produkte si:

- Raki
- Alkool etilik
- Vaj ushqimor
- Ushqim për kafshët, etj.

Mbetjet e gjeneruara nuk klasifikohen si te rrezikshme prandaj dhe nuk kerkojn etrajtim te vecant. Subjekti yne do ia dorzoje ato personave te interesuar per pleherimin e tokave bujqesore.

Mbetjet e ngurta urbane, nuk perzihen me ato te aktivitetit. Ato grumbullohen ne konteniere te ndare dhe depozitohen ne kontenieret e pastrimit te zones, nga subjekti i pastrimit te mbetjeve urbane.

Nuk ka shkarkime te ujerave te ndotura. Ujerat jane ato sanitare dhe te pastrimit te ambjenteve te aktivitetit

Ujerat e aktivitetit, grumbullohen ne nje kolektor kryesor, i cili sherben dhe si vaske dekantimi dhe me pas bashkohen ne sistemin e shkarkimeve te zones.

Objekti eshte i pajisur me sistem kanalizimesh si ne terrenet e jashtem edhe ne sistemin e objektit. Ujerat e shiut nuk perzihen me ato sanitare. Nuk ka problem permytjeje, ujerat kane sistem kullimi te mire projektuar.

4. VESHTRIM MBI MJEDISIN E RAJONIT TE IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT

4.1. Te pergjithshme per Qarkun e Kuksit

Zona Gjeografike: Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.



Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km² me një densitet prej 63.59 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 51.38 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia Kukës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Kukës	Qyteti Kukës	Kukës	Qyteti Kukës; Fshatrat; Gostil, Drinas	47,985	59,393	933.86
		Malzi	Fshatrat; Shëmri, Shtanë, Petkaj, Mguille, Çam, Gdheshte, Pistë, Spas, Shikaj, Dukagjin, Kalimash, Kryemadh			
		Bicaj	Fshatrat; Bushat, Bicaj, Osmane, Mholaj, Mustafaj, Nangë, Kolesjan, Domaj, Gabricë, Tërshenë			
		Ujmisht	Fshatrat; Lusën, Zallë, Malqene, Resk, Ujmisht, Skavicë, Tejdrine			
		Tërthore	Fshatrat; Morinë, Bardhoc 1, Bardhoc 2, Breg-Lumë, Pobreg, Gjegjan			
		Shtiqën	Fshatrat; Shtiqën, Koder Lume, Krenze, Gjallicë			
		Zapod	Fshatrat; Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikël, Bele, Lojmë			
		Shishtavec	Fshatrat; Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Cërnalevë			
		Topojan	Fshatrat; Topojan, Xhaferraj, Turaj, Brekije, Nimçë			
		Bushtricë	Fshatrat; Bushtricë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat			
		Gryk-Çajë	Fshatrat; Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak			
		Kalis	Fshatrat; Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pralisht			
		Surroj	Fshatrat; Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj			
		Arrën	Fshatrat; Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë			
		Kolsh	Fshatrat; Kolsh, Mamëz, Myç-Mamëz			

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kukës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 87 fshatra

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimin të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj).

Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti uxor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan. Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar. Mirëpo kjo shkaktoi shumë plagë sociale, duke krijuar një numër të madh të papunësh. Moszgjdhja në kohë e problemeve të pronësisë mbi tokën (veçmas problemeve të mbartura, të krijuara nga shpërngulja e detyrueshme e banorëve të Kukësit të Vjetër pas ndërtimit të

HEC-it të Fierzës) shkaktuan shumë konflikte pronësie dhe bllokuan tërësisht nismat e biznesit vendas dhe atij të huaj, duke krijuar një ngërç absurd që ende sot e kësaj dite vazhdon të mbajë nën tension shumë prej banorëve të Kukësit.